



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Datë: 06.03.2026

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174, Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110, në pajtim me dispozitave e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, si dhe në harmoni me nenin 37 të Udhëzimit Administrativ MMPH – NR.24/2015 Mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, Komisioni për Përjashtimet thërret:

TAKIM PUBLIK

Komisioni për Përjashtimet mbi kërkesat për Kushte ndërtimore /Leje ndërtimore, organizon Takim Dëgjimorë të hapur dhe publik me qytetarët e interesuar për trajtimin e kërkesës / parashtrësës për përjashtime në zonën si:

- Zona jug lindore e Komunës së Gjakovës – zona përgjatë rrugës tranzite ish “ Tirana “, parcela kadastrale (pjesë) me numër P-70705028-05077-2 Z.K. Gjakovë jashtë qytet., aplikuesi Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për ngritjen e objektit “SHTËPI PËR MBROJTJEN DHE EDUKIMIN E FËMIJËVE;

Qëllimi i dëgjimit publik është shqyrtimi i propozimeve për përjashtime për Kushte ndërtimi / Leje ndërtimore, në lokacionin të cilin e gjeni të bashkëngjitur me këtë Njoftim Publik.

Lokacioni për ndërtimin e objektit të banimit sipas destinimit të përcaktuar me dokumentin e planifikimit hapësinor si Harta Zonale e Komunës 2024-2032 dhe kërkesa për përjashtim që i referohet mundësimin të shfrytëzimit dhe zhvillimit të parcelës pa përmbushur kushtin e locimit të ndërtimit / pozicionimit të vijës ndërtimore në distancë 6.0m nga vija rregulluese e rrugës publike qasëse në parcelë dhe ky element imponohet nga forma jo e rregullt e parcelës kadastrale për zhvillim dhe kufizimi, pozicionimi dhe rregullimi i shtratit të lumit Trakaniq, për:

- PËRJASHTIMI I REFEROHET APLIKIMIT TË VIJËS SË NDËRTIMIT NË DISTANCË D=6.0M’ NGA VIJA RREGULLATIVE ;


Takimi Dëgjimorë dhe Publik me qytetarët e interesuar do të mbahet me datën 13.03.2026 (e premtë), në orën 10⁰⁰ në sallën e madhe të Kuvendit të Komunës së Gjakovës.

Kopjet fizike të këtyre dokumenteve mund të tërhiqen në objektin e Administratës të Komunës së Gjakovës, rruga “UÇK”, Nr. 53, 50000 Gjakovë çdo ditë pune prej orës 10⁰⁰ deri në orën 14⁰⁰, duke filluar nga data 06.03.2026 deri në ditën e organizimit të takimit publik me datë 13.03.2026, pranë Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Kryesuesja e Komisionit
Elida Bejtullahu

Propozim Lokacioni për kushte ndërtimit

1. Destinimi i objektit - *Shtëpia për Mbrojtjen dhe Edukimin e Fëmijëve (objekt në shërbim të komunitetit), me etazhitet P+1 dhe P+0, me sipërfaqe të objektit / ISHPKZH - 375.00 m²;*
 2. Vija e ndërtimit (VN) nga vija rregulluese - *Aplikuar nga ana veriperëndimore max. 15.53m' - min. 6.00m';*
 3. Lartësia e objektit - *Aplikuar max. 8.00m' - min. 4.00m' për P+1 dhe P+0;*
 4. Distanca nga objektet e banimit social ana majtë - *Aplikuar nga ana jugperëndimore max. 11.00 m' - min. 11.00 m';*
 5. Distanca nga kufiri anësor ana djathtë - *Aplikuar nga ana verilindore max. 10.70 m' - min. 7.80 m';*
 6. Distanca prapa (shetitorja e lumit) - *Aplikuar nga ana juglindore max. 24.21m' - min. 5.51 m';*
 7. Kulmi - *mund të jetë i rrafshhtë apo i pjerrët - sipas zgjedhjes së projektantit;*
 8. Niveleta - *dysheheja e përdheshës në raport me niveletën e rrugës publike duhet të jetë min. 0.20m';*
 9. Kërkesa minimale për vendparkingje - *1 VP / 100 m² për objekte të komunitetit (Shëndetësi dhe mirëqenje sociale);*
- Vërejtje:** Dimenzionet e objektit janë pa shtresat finale të izolimit termik dhe akustik.



Propozim lokacioni për ndërtimin e objektit të kategorisë II-të me destinim , Shtëpia për Mbrojtjen dhe Edukimin e Fëmijëve (objekt në shërbim të komunitetit), me etazhitet P+1 dhe P+0, me sipërfaqe të objektit / ISHPKZH - 375.00 m², në parcelat kadastrale P-70705028-05077-2, Z.K. Gjakovë Jashtë Qytet, në harmoni me Hartën Zonale Komunale / **Kapitulli 15. Përfshirje - në zona ku me kushte baze të Hartës Zonale janë të privuar nga e drejta për zhvillim të parçelës për arsye të zhvillimit të zonës mbi 80% me kushte të Planeve Rregulluese (përfshirje kërkohet vetëm sa i përket vijës ndërtimore në këtë rast), kushtet e Hartës Zonale nuk japin mundësi zhvillim për arsye të kushteve specifike të përcaktuara me Hartë Zonale dhe si të tilla do të vazhdojnë të zhvillohen me kushtet e Planeve Rregulluese në fuqi**, i vendosur në kërkesën për Kushte ndërtimore me nr. 07-351/02-35136 të datës 08.07.2025.

Dt. 27.02.2026, Gjakovë

Zyrtar i Lartë për Planifikim Urban - Msc.Ark. Rozafat Hoxha